

Rekomandime dhe konkluzione

A. Roli i parlamentit

B. Kapaciteti i Parlamenteve

C. Përgatitja për IPA II

A. Roli i parlamenteve në mbikëqyrjen e IPA financimit:

1. Anëtarët e rrjetit njohin rëndësinë e IPA financimit për përgatitje të vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrim në BE dhe rolin që parlamentet e Ballkanit Perëndimor duhet ta luajnë, që është një rol i rëndësishëm në mbikëqyrjen e këtyre fondeve.
2. Rrjeti dhe parlamentet inkurajohen të rrisin vetëdijen mes anëtarëve mbi IPA fondet dhe parlamentet duhet të luajnë rol më të dukshëm në informimin e qytetarëve të tyre mbi qëllimet dhe përfitimet e IPA.
3. Parlamentet duhet të inkurajohen që të zhvillojnë kulturën e mbikëqyrjes së seancave të rregullta vjetore mbi mbikëqyrjen e IPA fondeve.
4. Parlamentet inkurajohen të përfshijnë shoqëritë civile dhe aktor tjerë jo-qeveritarë në procesin mbikëqyrës.

B. Zhvillimi i kapaciteteve të Parlamenteve për mbikëqyrje:

1. Rrjeti duhet të inkurajon parlamentet të shkëmbejnë dhe të miratojnë praktikat më të mira mbi mbikëqyrjen financiare të fondeve të strukturuar.
2. Rrjeti duhet të inkurajon qeveritë që të ju sigurojnë parlamenteve qasje ndaj raporteve të rregullta dhe burimeve të informatave, veçanërisht pasi që zbatimi i IPA bëhet më i decentralizuar.
3. Rrjeti dhe donatorët duhet të përkrahin zhvillimin e komiteteve të parlamenteve, mundësitë kërkimore dhe mbikëqyrëse. Gjithashtu inkurajojmë parlamentet të caktojnë anëtar dhe personel si pika kyçe për mbikëqyrje të IPA fondeve.
4. Rrjeti duhet të zbatojë më tepër trajnim dhe zhvillim të punonjësve parlamentar që të përfitojnë njohuritë dhe veglat e nevojshme për të mbështetur vëzhgimin e IPA fondeve.

C. Përgatitja për IPA II

1. Parlamentet duhet herët të përfshihen në bisedat me qeveritë dhe delegacionet e BE mbi dokumentet strategjike të vendit , strategjitë sektoriale, përcaktimin e prioriteteve, marrëveshjet kornizë dhe programet afatgjatë.
2. Parlamentet duhet më shumë të përfshihen me komitetin mbikëqyrës të Parlamentit Evropian mbi IPA. Rrjeti duhet të ketë parasysh vizitë nga IPA grupi i punës në Parlamentin e BE, me qëllim që të shohin se cila është mënyra më e mirë për Parlamentet e Ballkanit Perëndimor të zhvillojnë këto lidhje..
3. Parlamentet duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Institucionet Revizore Qeveritare dhe Shtetërore që të kuptojnë sfidat dhe leksionet nga zbatimi i IPA I.
4. Parlamentet duhet të vazhdojnë me përkrahjen pozitive dhe inkurajimin për administratat qeveritare me qëllim të përmirësimit të nivelit të absorbimit të IPA fondeve.